



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i procesverbalit.

Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar”” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Edmond Leka, Fadil Nasufi dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka, Gjetan Gjetani, Dritan Bici dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Enis Aliko - Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Stavri Dhima - Përgjegjës sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Anisa Pine - Specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Aldo Xherahu - Fotograf në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Saimir Muçmataj - Përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përshëndetje!

Përpara se të fillojmë, jeni dakord me procesverbalin e mbledhjes së kaluar?

Miratohet procesverbali.

Përpara se të kalojmë te agjenda e ditës së sotme, zoti Beqaj, ke diçka për procedurë?

Ilir Beqaj – Po.

Eduard Shalsi - Në lidhje me...

Ilir Beqaj - Në lidhje me vazhdimin e buxhetit të paketës fiskale nen për nen.

Ditët janë shumë të ngushta. Mos duhet ta bëjmë një mbledhje që të premten?

Eduard Shalsi – Po.

Ilir Beqaj – Ta diskutojmë bashkërisht se cili është orari më i përshtatshëm, se nuk e di sa gjatë mund të na shkojë seanca e së enjtes. Çfarë kemi për ta çuar...

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk e bëjmë dot mbledhjen e së premtes pa votimin e së enjtes. Duhet të votohet në parim, që ne të hyjmë...

Eduard Shalsi – E premtja është taksative që do të bëjmë mbledhje. Thjesht do të caktojmë orarin, sepse është dita kur do të votojmë dhe pastaj shkojmë direkt në seancë plenare, sepse ka...

Ilir Beqaj - Do të bëjmë edhe amendimet.

Eduard Shalsi – Propozimet për amendimet.

Ilir Beqaj – Po pra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Seanca është e gjatë, nuk dihet sa do të zgjasë. Seanca për buxhetin kam përshtypjen se do të jetë e gjatë. Formalisht, pa votuar, nuk e bëjmë dot.

Eduard Shalsi – Përveç Bertit, ditën e premte, në orën 10:00 ka njeri tjetër që nuk do të jetë?

Tina ku është?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur vjen Tina?

Ilir Beqaj – Besoj se nesër do të vijë për të votuar. Kështu që të premten në Tiranë do të jetë.

Eduard Shalsi – Neve na duhen 10 veta për kuorumin, që do të thotë...

Me përjashtim të Bertit, nëse janë gjithë të tjerët, e lëmë për të premten në orën 10:00. Duhet bërë me patjetër.

Ilir Beqaj – Sot, kur të mbarojmë çështjen e rendit të ditës, mirë është të biem dakord me njëri-tjetrin se çfarë çështjesh do të diskutojmë të premten, në mënyrë që sot dhe nesër të punojmë për 5-6 çështjet që kemi.

Eduard Shalsi – Në rregull.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Eduard Shalsi – Atëherë, kalojmë te projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar”. Relator është zoti Marto.

Të ftuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë zoti Enis Aliko dhe zoti Stavri Dhima, të cilëve u uroj mirëseardhjen në komision!

Befasi ishte ardhja e këtij ligji në parlament, i nderuar zëvendësministër, sepse, të them të drejtën, vetëm para 2-3 javësh pati një ndryshim te ligji për sektorin e gazit natyror.

Gjithsesi, do të flasë zoti Marto në cilësinë e relatorit apo doni t’ia japim fjalën zëvendësministrit?

Mirë, zoti Aliko, fjala për ju.

Enis Aliko – Faleminderit për ftesën në komision!

Kjo pjesë e ligjit nr. 102/25015 është për të lehtësuar klimën e biznesit dhe është në kuadër të derregullimit që është duke bërë qeveria.

Është e vërtetë që ligji është ndryshuar dhe nuk ka kaluar shumë kohë, por ky është një ndryshim i pavarur nga ndryshimet e tjera, sepse është në kuadrin e deregullimit. Këtu, praktikisht, bëjmë ndryshim për të hequr një licencë.

Eduard Shalsi – Që është...?

Enis Aliko – Është licencë për veprimtaritë studimore projektuese për personat fizikë ose juridikë, për kategorinë IV-b. Me këtë ndryshim ne lehtësojmë zhvillimin e aktiviteteve, në përgjithësi në fushën e hidrokarbureve. Kjo nuk është për gazin.

Neni 5 i ligjit nr. 102 përfshin gjithë fushën e hidrokarbureve dhe, ky derregullim, kjo heqje licence, do të prekë gjithë fushën e hidrokarbureve.

Eduard Shalsi – E shpjegon dot më konkretisht, që ta kuptojnë edhe deputetët? Na tregoni një rast konkret për një kompani apo një biznes, se si ishte më parë dhe çfarë ndodh tani.

Sa kërkesa ka pasur më parë?

Çfarë do të thotë ta lehtësosh dhe të marrësh një masë të tillë?

Enis Aliko – Deri tani, për të kryer këtë veprimtari studimore projektuese, të gjithë peronat fizikë ose juridikë duhet të pajiseshin me licencë, me certifikatë, që e jep ministria dhe me licencë, që e jep QKB-ja. Në 2 vjet e gjysmë, që kur është bërë ky ligj, deri tani janë licencuar 35-40 persona juridikë ose subjekte.

Kjo kërkesë hiqet, mbetet vetëm certifikata.

Eduard Shalsi – Pra, mbetet vetëm licencë për...?

Enis Aliko - Për veprimtari studimore dhe projektuese në fushën e hidrokarbureve, gaz dhe naftë.

Do të mbesë certifikata, të cilën e jep ministria dhe do të hiqet licenca e dhënë nga QKB-ja. Kjo licencë do të zëvendësohet me detyrimin e personit fizik ose juridik që ta ketë të regjistruar në QKB, në fushën e veprimtarisë së tij, edhe këtë veprimtari studimore projektuese. Pra, tani do të ketë dy detyrime. Personat juridikë/fizikë, që duan ta kryejnë këtë veprimtari duhet të marrin certifikatën profesionale dhe duhet të kenë të regjistruar në QKB veprimtarinë. Hiqet nevoja e licencës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I punësuar, në rastin e një kompanie, duhet të ketë një të punësuar që të ketë certifikatë nga ministria. Kompania duhet të ketë të regjistruar në QKB edhe veprimtarinë studiuese si veprimtari. Në rast se është person fizik, duhet t'i ketë të dyja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si fushë duhet ta këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht.

Thjeshtohet, hiqet një hallkë.

Eduard Shalsi - Po, zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Faleminderit!

Përse e kërkon këtë ndryshim?

Çfarë ka ndodhur në praktikë? Çfarë problemi keni?

Çfarë është krijuar që kërkon ndryshimin për heqjen e kësaj licence?

Si ka funksionuar deri tani? Pse ka ndodhur kjo?

Enis Aliko – Mund të përgjigjet edhe Stavri, por...

Eduard Shalsi – Po, Stavri.

Stavri Dhima – Faleminderit!

Sidomos në aktivitetin e kompanive dhe subjekteve që merren direkt me veprimtari studimore projektuese dhe janë shumë studio, shumë institucione të biznesit privat, ishte e detyrueshme që, përveçse në fushën e aktivitetit të tyre, të kishin të përfshirë edhe këtë veprimtari, si çdo lloj biznesi, siç e tha edhe zoti Bitri, e kishin të detyrueshme të aplikojnë me një dosje të veçantë për të marrë licencë aktiviteti. Pra, jo vetëm që do të kishte të punësuar persona të aftë dhe të certifikuar nga ministria për ta bërë këtë biznes, por kompania ose subjekti duhet të merrte edhe një licencë, gjë e cila jo vetëm harxhonte kohë, se nuk po e quajmë shpenzim, por kishte edhe problemet e veta.

Për shembull, 2 studio, të cilat janë të angazhuara pranë kompanisë TAP, që të zhvillojnë këtë aktivitet kishin si detyrë të merrnin licencën, por ato ishin licencuar një herë, sepse mund të ishin në supervizim, mund të ishin në studime dhe projektme për aktivitetin, gjë e cila krijonte një farë sorollatjeje. Kjo licencë tashmë do të hiqet, jo thjesht për aktivitete, studime dhe projektme në fushën hidrokarbure, por edhe për studime, projektme në fushën minerare, si dhe për studime, projektme në fushën e ndërtimit. Pra, të gjitha këto lloje licencash do të hiqen. Ky është një koordinim ndërmjet ministrisë sonë, që mbulon këtë aktivitet dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, në kuadër të politikës së deregullimit, që drejtohet nga zonja zëvendëskryeministre.

Eduard Shalsi - Zoti Beqaj...

Ilir Beqaj – U bënë 6-7 muaj që këtu vijnë herë pas here ligje, që janë pjesë e po këtij procesi. Javën e kaluar votuam dhe ia hoqëm Demit licencën.

Tani, ju thatë se në këta 3 vjet janë licencuar rreth 35 subjekte. Pra, këtyre subjekteve nuk u lehtësojmë më gjë, se këta e kanë marrë licencën.

1 herë në sa vite rinovohet licenca?

Stavri Dhima – Jo licenca, ne po themi se janë 40 subjekte, sepse mund të jenë edhe persona fizikë.

Ilir Beqaj – Po pra. Sa subjekte janë deri sot? Ju thatë 35.

Stavri Dhima – Vetëm para 3 ditësh certifikuam, jo licencuam, edhe 6 persona të tjerë.

Ilir Beqaj – Pra, u bënë 40.

Stavri Dhima – Ndërkohë, specialistë të fushës së sektorit të naftës dhe të gazit, të cilët do të merren... Veprimtaria studimore projektuese përfshin kërkimin, prodhimin, përpunimin, rafinimin, përfshin edhe transportin dhe tregtimin, përfshin edhe ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Deri sot janë 40 subjekte.

Stavri Dhima – Mund të bëhen edhe 40 apo 60 të tjerë.

Ilir Beqaj – Pra, ka hapësirë edhe për 60 të tjerë.

Stavri Dhima– Absolutisht po.

Ilir Beqaj – Dakord.

Para këtij ndryshimi, sa ditë zgjat gjithë cikli mesatarisht?

Stavri Dhima– Në ministrinë tonë....

Ilir Beqaj – Gjithsej, jo në ministrinë tuaj.

Stavri Dhima – Kemi edhe certifikimin, edhe licencimin, që deri tani kanë qenë pjesë e së njëjtës gjë. Certifikimi mund të ishte 1 muaj...

Ilir Beqaj – Sa zgjat gjithë procesi?

Stavri Dhima – Gjithë proces mund të zgjasë edhe 3 muaj.

Ilir Beqaj – 90 ditë deri më sot.

Mbas këtij ndryshimi që do të miratojmë, sa do të zgjasë gjithë procesi?

Stavri Dhima - 30 ditë.

Ilir Beqaj – Pra, nga 90 ditë në 30 ditë.

Stavri Dhima – Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Po çfarë rëndësie ka?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një zyrë ku duhet të marrësh një miratim.

Pyetja e fundit: nisur nga ndjeshmëria që kanë këto burime natyrore për sigurinë kombëtare, e gjykoni të balancuar sigurinë kombëtare me këtë nxitimin për derregullim?

Enis Aliko – Po, e gjykojmë shumë të balancuar, pasi kjo do të kalojë përsëri nga certifikimi, që është në ministrinë tonë. Hiqet thjesht hallka e licencimit, gjithashtu, edhe detyrimi për ta futur këtë veprimtari në objektin e veprimtarisë së subjektit. Pra, në kuadrin e QKB-së ajo mbetet, kurse në kuadrin e ministrisë, që shqyrton të gjitha aspektet e tjera, është siç ka qenë dhe nuk ka asnjë ndryshim.

Ilir Beqaj – Çfarë e ka penguar ministrinë tuaj, që, në qoftë se kishte afatin për të dhënë përgjigje 30 ditë, ta bënte këtë për 3 ditë?

Stavri Dhima – Për dhënien e certifikatave profesionale për këtë aktivitet studimor projektues, ligji autorizon nxjerrjen e një vendimi qeverie, i cili ka dalë dhe është në fuqi. Në zbatim të këtij vendimi qeverie është ngritur një komision, i cili ka një procedurë të caktuar dhe personi që aplikon për të marrë këtë certifikatë nga ministria, duhet të paraqesë një sërë dokumentesh që vërtetojnë disa gjëra: që minimalisht ka mbaruar shkollën, ka një

eksperiencë punë 5 apo 10 vjet në një fushë, për shembull në përpunim, kërkim e të tjerë. Minimalisht duhet të vërtetohet që nëse kërkon studime dhe projekte, i ka vërtetuar edhe këto. Pra, është një set kërkesash, që përpara se të paraqiten në komision... Një kërkesë mund të vijë sot, një pas një muaji, një pas 10 ditësh. Kërkesat vijnë në mënyrë sporadike, sepse janë zgjedhje individuale dhe drejtoria përkatëse, njësia përkatëse në ministri, që mbulon sektorin e hidrokarbureve, bën shqyrtimin dhe verifikimin e këtij dokumentacioni, për të cilin mund të duhen 3,5, apo 7 ditë, sipas...

Ilir Beqaj – Bëjeni për 5 orë, pse e bëni për ditë?

Stavri Dhima – Për 5 orë ajo vetëm sa hyn në ministri dhe të kalojë procedurat e regjistrimit në protokoll dhe të kalimit në...

Ilir Beqaj – Bëjeni *online*, nga protokollin nëpër zyra.

Stavri Dhima – Nuk është problemi i procesit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ato përfshijnë të gjithë dokumentacionin, i cili duhet të verifikohet, për të qenë korrektë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj – Ka kohën e verifikimit

Stavri Dhima – Patjetër që ka kohën e verifikimit.

Eduard Shalsi – Zoti Marto e ka fjalën.

Andrea Marto – Siç u tha edhe nga zëvendësministri dhe miku ynë Stavri, që ka një jetë në atë pozicion, ky projektligj vjen në kuadër të reformës së derregullimit, i cili ka si qëllim krijimin e lehtësirave të mëtejshme për përmirësimin e klimës së biznesit nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative.

Ndryshimi synon reduktimin e barrierave administrative, liberalizimin e tregut dhe përmirësimin e mëtejshëm të klimës së biznesit.

Ushtrimi i veprimtarisë së shërbimeve të ekspertizës ose shërbimeve profesionale për burimet e hidrokarbureve duhet të jetë i lirë, por duke parashikuar që personat fizikë ose juridikë duhet të kenë regjistruar në regjistrin tregtar si objekt të veprimtarisë së tyre kryerjen e kësaj veprimtarie, si dhe të kenë punësuar specialistë të pajisur me certifikatë profesionale. Pra, kjo lehtësohet dhe nuk ka më nevojë të dalë vendim ministri në përputhje ish-vendimin e Këshillit të Ministrave, pra është një lehtësim i procedurës.

Ndryshimi i amendimeve për ligjin për gazin ka ardhur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, kurse ky deregullimi vjen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Eduard Shalsi – Prandaj ka mospërputhje.

Ilir Beqaj – Kam edhe një pyetje. Nisur nga parashtrësja që bëtë, do të na duhet të prekim edhe ligjin për hidrokarburet?

Enis Aliko – Jo, nuk preket ligji për hidrokarburet, sepse neni 5 i ligjit nr. 102, në fillim të pikës 5, thotë: “Ministri, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, jep certifikata profesionale për specialistët, që kryejnë veprimtari studimore, projektuese dhe zbatuese në fushat e përcaktuara me këtë ligj, si dhe në fushat e kërkimit, prodhimit, përpunimit, transportit, depozitimit e tregtimit të hidrokarbureve në tërësi.” Pra, fjalia e parë e pikës 5 të nenit 5, bën një shtesë për të gjitha hidrokarburet. Fjalia e dytë është ajo që ne po ndërrojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Ka ndonjë koleg tjetër për të thënë diçka? Nuk ka.

Atëherë, duke ju falënderuar për shpjegimet, kalojmë në votimin në parim!

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kundër?

Ilir Beqaj – Dyshoj se cenohet siguria kombëtare.

Eduard Shalsi – Në parim je kundër? Dakord.

Neni 1.

Pro? 1 kundër, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Pro? 1 kundër, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Votohet në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Falënderojmë të ftuarit!

Ne të vazhdojmë të qëndrojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është ditën e enjte. Elona, është pasnesër?

Elona Toto – Në datën 20 dhjetor.

Eduard Shalsi – Dakord.

Ilir Beqaj – Mundem?

Eduard Shalsi – Po.

Ilir Beqaj – Zoti Zëvendësministër, kemi diskutuar gjatë paketës fiskale edhe me përfaqësues të industrisë së kromit, që ishin këtu për rentën. Ajo tani ka kaluar, por sipas tyre kërkesat financiare që ka ligji ynë minerar aktualisht, që duhet të jetë dikush që t'i eksplorojë, janë aq të larta, saqë ata thanë se ka 7 vjet që në krom nuk po bëhen kërkime të reja. Folëm për kromin, meqenëse për atë po diskutohet, por kjo mund të jetë edhe në...

Enis Aliko – 100% e drejtë.

Ilir Beqaj – E drejtë? Mirë atëherë,...

Enis Aliko – Nuk janë 7 vjet, por janë më shumë.

Ilir Beqaj – Ligji ishte i 2011-s më duket... Mund të ketë edhe më shumë, por po e marrim që kur është bërë ligji.

Keni në plan të merreni me këtë çështje? Apo të merremi ne si komision? Në qoftë se e keni ju në plan, nuk ia vlen...

Enis Aliko – E kemi filluar.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Enis Aliko – Sapo të jetë gati, do ta...

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Enis Aliko – Faleminderit juve!

Eduard Shalsi – Duke ju falënderuar, ju uroj punë të mbarë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Le të rrinë, nuk ka problem. Për paketën fiskale, biem dakord të bëjmë një mbledhje të premten në orën 10:00, ku do ta miratojmë nen për nen dhe do t'i propozojmë Komisionit të Ekonomisë të gjitha sugjerimet dhe komentet tona.

E përsërisë edhe një herë, për çështjen e kromit kemi propozuar që nga 6% të mos shkojë menjëherë 9%, por çdo vit të bëhet me nga 1%, pra 2019-a 7%, 2020-a 8% dhe 2021-shi 9%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E diskutojmë si opion, mendojeni dhe pastaj të bëjmë propozimet.

Së dyti, për rërat bituminoze, propozimi ka qenë nga 0,3 në 0,5%, ndërkohë që propozimi i qeverisë ishte 2%, ka zbritur dhe parimisht është rënë dakord për 1%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kanë sjellë me 1%?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fillimisht ishte 2%, e kanë sjellë me 1%.

Ndërkohë, pas analizave, duke pasur parasysh edhe fuqinë kalorifike të rërës bituminoze, krahasuar me koksin, që ishte materiali zëvendësues, konkludua që është e përshtatshme të vijë në nivelin e 0,3-0,4, maksimumi 0,5%. Personalisht insisto për 0,3-0,4%.

Kemi një pikë të pambyllur ende, për të cilën sot kam dy kërkesa të tjera për takime: 100 lekë për plastikën, për atë që është 100 lekë dhe bëhet 35 lekë dhe për atë që është zero dhe bëhet 25 lekë për lëndën e parë, granulën.

Diskutimi i fundit nuk është se na ndryshoi shumë mendim. Ka një propozim që nga 35 lekë dhe respektivisht 25 lekë, të bëhet 40 dhe 20 lekë, gjë që do ta bëjmë pjesë të diskutimit ditën e premte, kur të...

Argumenteve nuk u dhamë përgjigje, në fakt, se sa ndikoi... Nuk e di sa të përgatitur do të jenë ata po që se do t'i dëgjojmë nesër ose pasnesër...

(Diskutime pa mikrofon)

Në rastin konkret... Një sekondë!

(Diskutime pa mikrofon)

Të lutem!

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – ... Sot është zero-zero.

Vullnet Sinaj – Si zero-zero?

Ilir Beqaj– Nuk ka taksa.

Vullnet Sinaj – Paguhet 100 lekë për ambalazh dhe zero lekë për granulatet. Lëre zero atë. Ç'ke që e ngacmon? Lëre siç është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Personalisht, paguaj lekë për ambalazhin, o Beqaj.

Ilir Beqaj - E di.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Diskutime pa mikrofon)

MBYLLET MBLEDHJA